



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit

---

Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit hap thirrje për një përfaqësues të shoqërisë civile për anëtar të Komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve në Komisionin e Ankesave të Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

**Për të përzgjedhur përfaqësuesin e shoqërisë civile në Komision, ftohen OSHC-të aktive në Kosovë për të nominuar përfaqësuesit e tyre. Ftesa është e hapur për të gjitha OSHC-të e regjistruara dhe rrjetet e OSHC-ve në Kosovë, pavarësisht anëtarësimit në Platformën Civikos.**

#### **KRITERET PËR ORGANIZATAT QË NOMINOJNË KANDIDATËT e TYRE**

Të drejtën për të nominuar kandidatë kanë të gjitha OShC-të që:

- Janë të regjistruara sipas Ligjit për Liri të Asocimit në Kosovë;
- Ekzistojnë të paktën gjatë 5 viteve të fundit;
- Kanë për fushëveprim arsimin, arsimin e lartë, monitorimin në fushën e arsimit.

**Për t'u nominuar nga një OShC, kandidati/ja duhet t' i plotësojë kriteret në vijim:**

- Të jetë i/e angazhuar në sektorin e shoqërisë civile në Kosovë;
- Të jetë shtetas/e i/e Republikës së Kosovës;
- Të ketë kualifikim superior në fushën e arsimit (preferohet master);
- Të ketë se paku pesë (5) vjet përvojë pune në shoqëri civile, në fushën e arsimit;
- Mos të ketë angazhim në Agjencinë e Kosovës për Akreditim në 5 vitet e fundit.

## **PROCEDURA E NOMINIMIT DHE VERIFIKIMIT**

E gjithë procedura e nominimit dhe përzgjedhjes menaxhohet nga Sekretariati i Platformës CiviKos, nëpërmjet procesit të nominimit dhe Formularëve për Votim, ku përcaktohen qartë të gjitha kushtet e kërkuara dhe dokumentet shtesë.

**Të gjitha OShC-të që nominojnë kandidatët e tyre obligohen që në periudhën nga 10.02.2022 deri me 16.02.2022 të dërgojnë dokumentet e kërkuara për nominim të kandidatit/es si më poshtë:**

- 1. Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së,**
- 2. Një përshkrim (max 1 faqe) për fushëveprimtarinë e organizatës dhe misionin;**
- 3. Një cv të kandidatit/es që organizata e nominon.**

**Të gjitha këto dokumente mund ti dërgoni përmes email në [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net), apo përmes postës, në adresën Rr. Bedri Pejani 7/A 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.**

Një panel verifikues i përbërë nga përfaqësues të Sekretariatit të Platformës CiviKos, dhe një përfaqësues nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit konfirmojnë plotësimin e kritereve të nominuarëve, para zyrtarizimit të listës përfundimtare për votim.

## **PROCEDURA E VOTIMIT**

Të drejtë për të votuar për kandidatët e nominuar kanë të gjitha OShC-të e regjistruara sipas Ligjit për Liri të Asociimit në OJQ në Republikën e Kosovës. Votuesit mund të hedhin votën e tyre me e-mail, në email adresën [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net), postë të rregullt, ose personalisht në zyrën e CiviKos në adresën Rr. Bedri Pejani 7/A 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në rastin e votimit me e-mail ose me postë të rregullt, organizata që voton duhet të dërgojë fletëvotimin e plotësuar dhe kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së. Në rastin e votimit në zyrën e CiviKos, organizatat duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së dhe të hedhin fletëvotimin e tyre në kutinë e votimit në zyrën e CiviKos. Votimi anonim mund të bëhet vetëm nëpërmjet votimit në zyrën e CiviKos.

Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos, që caktohet nga Drejtori Ekzekutiv i CiviKos. Pas përfundimit të afatit për votim, komisioni i Sekretariatit të Platformës CiviKos do të numërojë fletëvotimet për të përcaktuar se cili(a) kandidat(e) ka marrë numrin më të madh të votave. Nëse dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, përfaqësuesi i OShC-ve do të përcaktohet me short në mes tyre.

Për të mbikëqyrur procesin e numërimit të votave, Platforma CiviKos do të ftojë në cilësinë e vëzhguesve të gjitha OShC-të që kanë bërë nominime, rrjetet aktive të shoqërisë civile, përfaqësuesit e Ministrisë Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit.